



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 604/1 Prot.

Tiranë, më 29. 04. 2024

V E N D I M

Nr. 118, Datë 29. 04. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr.86, datë 18.04.2024, e z. J. M¹, kundër Shoqërisë së Transportit të linjës Durrës-Porto Romano-Durrës, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *Ishte data 13-04-2024, isha tek varrezat e reja në Durrës. Rreth orës 11.00, zbrita tek stacioni i urbanit që është ngjitur me lokal Sali Kolldashi, aty ishte edhe një zonjë që priste urbanin ndërkohë erdhi një furgon që e njihte atë zonjë dhe iku me furgonin, unë ngela vetëm në stacion. Në orën 11:20 erdhi urbani, ngadalësoi shpejtësinë dhe kur më pa që isha me shkopin në dorë dhe vetëm, pa e hapur derën i dha shpejtësi autobusit dhe iku. Në këto rrethana u detyrova të pres urbanin e rradhës. Pasi hypa në urbanin e rradhës, pyeta faturinon se kush autobus ishte para jush, kush shofer ishte, më tha mua që nuk e dinte, më pas pyeta edhe shoferin dhe ai këtë përgjigje më dha, nuk e di. Zbrita nga autobusi tek sheshi "Pranvera" dhe iu drejtova zyrës ku furnizohen faturinot me bileta dhe pyeta se kush është përgjegjës i kësaj linje Durrës-Porto Romano, më tha se nuk jemi ne po shko te lokali aty afër. Shkova te lokali, pyeta se*

¹ Referuar Librezës së Invalidëve nr. 077, të lëshuar nga Shoqata "Shpresë për të Verbërit".

kush është përgjegjës për këtë linjë, unë tha njëri prej tyre. Më pyeti se çfarë halli ke, i thash se kam një ankesë për linjën Durrës - Porto Romano dhe i tregova ngjarjen e mësipërme dhe kërkova që të më mundësonte një takim me shoferin që ishte përgjegjës për rastit në fjalë. Më tha ik zhdukuri se ti më ke thyer një xham, unë i thash se xhamin nuk e theva unë, por shoferi i autobusit, përse i përket ngjarjes, në linjën Durrës – Universitet – Spitallë. Një vit më parë ka ndodhur një ngjarje e tillë tek Stacioni i Trenit, kam qënë bashkë me presidentin e Shoqatës z.Saimir Farrici dhe në momentin që do hynim në urbanin e linjës së Universitetit, shoferi mbylli derës, desh më zuri këmbën dera dhe nisi urbanin. Saimiri duke trokitur në xham na u tha se është thyer xhami, u njoftua edhe policia dhe ne e kemi sqaruar gjëndjen në polici. Fajtori doli shoferi dhe na u tha se është pushuar nga puna, ky është rast përsëritje nga kjo firmë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Shoqërisë së Transportit të linjës Durrës-Porto Romano-Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar si dhe rregullimin e pasojave që shkaktohen nga kjo linjë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Pas analizimit paraprak të ankesës rezultoi se pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin, i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Durrës-Poro Romano-Durrës si dhe mjetin për të cilin pretendon se ka kryer diskriminimin në datën 13.04.2024, duke mos ndaluar në stacionin e autobuzit që ai priste, ditë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese. Gjithashtu subjekti ankues nuk solli fakte dhe prova të tjera për të mbështetur sjelljen diskriminuese të pretenduar.

Në këto kushte Komisioneri vlerëson se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim të mëtejshëm, lidhur me ankesën e z. J. M.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;.....”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga z. J. M, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA